

Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur i
përgatitur bazuar në Standardet Ndërkombëtare të
Raportimit Financiar

Banka Kombëtare Tregtare Kosovë Sh.a.

31 dhjetor 2018

Përmbajtja

	FAQE
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	1
PASQYRA E POZITËS FINANCIARE.....	3
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE.....	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL.....	5
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	6
SHËNIMET MBI PASQYRAT FINANCIARE	7



Grant Thornton

Raporti i Auditorit të Pavarur

Për Aksionarët e
Banka Kombëtare Tregtare Kosovë Sh.a

Grant Thornton LLC
Rr. Rexhep Mala 18
10 000 Pristina
Kosovo
T +381 38 247 771
+381 38 247 801
F +381 38 247 802
www.grantthornton-ks.com

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Banka Kombëtare Tregtare Kosovë Sh.a (referuar tutje si “Banka”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2018, dhe pasqyrat e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhës së pasasë që mbyllet me këtë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2018, si dhe performancën financiare dhe rrjedhën e pasasë për vitin që ka përfunduar në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare në raportin tonë. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët Profesionist (Kodi BSNEK) së bashku me kërkesat etike që janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare në Kosovë dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin e BSNEK-së. Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga menaxhmenti, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa ndonjë anomali materiale si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e hipotezës së vijimësisë së Bankës, shpalosjet, çështjet e ndërlidhura me vijimësinë dhe përdorimin e bazës së vijimësisë në kontabilitet përpos nëse Menaxhmenti dëshiron të likujdojë Bankën, ndërprejë operacionet e Bankës ose nuk ka alternative reale por ta bëjë këtë veprim.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.



Raporti i Auditorit të Pavarur (vazhdim)

Për Aksionarët e Banka Kombëtare Tregtare Kosovë Sh.a (vazhdim)

Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tonë janë ofrimi i sigurisë së arsyeshme në lidhje me çështjen se a janë pasqyrat financiare të liruara nga gabimet materiale si rezultat i mashtrimit apo gabimit dhe lëshimi i një raporti të auditorit që përmbanë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit do të zbulojnë gabimet materiale nëse ato egzistojnë. Gabimet mund të ndodhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse individualisht apo në tërësi pritet që të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve që bazohen në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit, në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticismin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë riskun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare që vijnë si rezultat i gabimit apo mashtrimit, dizajnojmë dhe performojmë procedurat e auditimit në lidhje me ato risqe dhe mbajmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazën për opinionin tonë. Risku i moszbulimit të gabimeve materiale nga mashtrimet është më i lartë se sa ai i gabimit për shkak se risku i mashtrimit mund të përmbajë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo refuzime të kontrolleve të brendshme.
- Kuptojmë kontrollat e brendshme që janë relevante me auditimin në mënyrë që të dizajnojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme me rrethanat, mirëpo jo me qëllim për dhënien e një opinionit mbi efektivitetin e kontrollave të brendshme të bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e kontabilitetit si dhe shpalosjet e bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim përfundime në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit bazës së hipotezës së vijimësisë së kontabilitetit, duke u bazuar në evidencat e auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të shkaktojnë dyshim të lartë që banka mund të vazhdojë operimin. Nëse ne vijmë në përfundim se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar t'i kushtojmë vëmendje në raportin tonë të auditimit në shpalosjet e pasqyrave financiare ose nëse shpalosjet e tilla janë jo të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat tona të auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë.
- Vlerësimin e prezentimit, strukturës dhe përmbajtjes së përgjithshme të pasqyrave financiare duke përfshirë shpalosjet dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të angazhuar me qeverisjen për, përpos çështjeve të tjera, për shtrirjen, kohëzgjatjen dhe gjetjet e auditimit duke përfshirë mangësitë e mëdha eventuale në kontrollet e brendshme që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Grant Thornton LLC

Prishtinë,
15 prill 2019




Suzana Stavrikj
Auditor ligjor


Banka Kombëtare Tregtare Kosovë Sh.a.

Pasqyra e pozicionit financiar për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018
(në Euro)

	Shënimet	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Pasuria			
Paraja dhe balancat në Bankën Qendrore	6	53,319,751	36,515,212
Plasmanet dhe balancat në banka	7	18,271,569	1,374,043
Investimet në letra me vlerë	8	76,807,878	55,460,258
Të arkëtueshme nga BKT Shqipëria	25	10,641,096	1,871,765
Kreditë dhe paradhëniet te Bankat	9.1	-	30,537,890
Kreditë për klientët, neto	9.2	247,370,257	212,081,878
Prona dhe paisjet	10	1,769,094	1,972,635
Pasuritë e paprekshme	11	22,414	35,556
Të arkëtueshmet nga tatimi	27	360,903	128,202
Pasuri të tjera	12	3,744,294	5,228,308
Gjithsej pasuria		412,307,256	345,205,747
Detyrimet dhe kapitali aksionar			
Detyrimet			
Depozitat e klientëve	13	351,354,331	301,678,067
Detyrimet ndaj bankave	14	17,859,118	20,009
Detyrimi i tatimit të shtyer	27	213,306	331,124
Detyrimi i tatimit në të ardhura	27	-	-
Shpenzimet e përlogaritura dhe detyrime të tjera	15	1,652,109	2,552,934
Huamarrjet	16	4,085,314	5,906,343
Gjithsej detyrimet		375,164,178	310,488,477
Kapitali aksionar			
	17		
Kapitali aksionar		17,000,000	17,000,000
Fitimi i akumuluar nga vitet paraprake		16,082,038	11,914,542
Fitimi për vitin		4,370,402	5,841,933
Rezerva e vlerës së drejtë		(309,362)	(39,205)
Gjithsej kapitali aksionar		37,143,078	34,717,270
Gjithsej detyrimet dhe kapitali aksionar		412,307,256	345,205,747

Pasqyrat financiare janë autorizuar për lëshim nga Bordi i Drejtorëve më 15 Prill 2019 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:


Suat Bakkal
Kryeshef Ekzekutiv dhe Anëtar Bordi


Agon Skeja
Drejtues i Grupit të Financave dhe
Administratës

Shënimet e bashkangjitura prej 1 deri 29 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Banka Kombëtare Tregtare Kosovë Sh.a.

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018 (në Euro)

	Shënime	Për fund vitin 31 dhjetor 2018	Për fund vitin 31 dhjetor 2017
<i>Interesi</i>			
Të ardhura nga interesi	18	16,641,523	15,314,246
Shpenzimet e interesit	19	(2,889,809)	(2,766,932)
Të ardhurat neto nga interesi		13,751,714	12,547,314
<i>Të ardhurat nga jo-interesi, neto</i>			
Tarifat dhe komisionet, neto	20	3,494,534	3,355,515
Fitimi nga rivlerësimi i kursit të këmbimit, neto		19,192	1
Humbja nga aktivitetet tregtare në valuta të huaja, neto		78,086	(86,819)
Të ardhura të tjera	21	(30,385)	146,866
Gjithsej të ardhurat e tjera, neto		3,561,427	3,415,563
<i>Shpenzimet operative</i>			
Shpenzimet e personelit	22	(3,941,998)	(3,903,705)
Shpenzimet administrative	23	(5,089,442)	(4,612,505)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	10,11	(641,750)	(711,670)
Gjithsej shpenzimet operative		(9,673,190)	(9,227,880)
Shpenzimet e provizioneve për kreditë e klientëve	9.2	(2,146,664)	(365,552)
Shpenzimet e provizioneve për pasuritë financiare, përveq kredive ndaj klientëve	24	(689,222)	-
Fitimi para tatimit në fitim		4,804,064	6,369,445
Tatimi në fitim	27	(433,662)	(527,512)
Fitimi neto për vitin		4,370,402	5,841,933
Rivlerësimi i investimeve në letra me vlerë		(270,157)	(39,204)
Të ardhura/shpenzime tjera gjithëpërfshirëse për vitin		(270,157)	(39,204)
Gjithsej humbja/fitimi gjithëpërfshirës për vitin		4,100,245	5,802,729

Shënimet e bashkangjitura prej 1 deri 29 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Banka Kombëtare Tregtare Kosovë Sh.a.

Pasqyra e ndryshimit në kapital për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018

(në Euro)

	Kapitali aksionar	Rezervat e vlerës së drejtë	Fitimet e mbajtura	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2017	17,000,000	(1)	11,914,542	28,914,541
Transaksionet me pronarët të regjistruara direkt në kapital	-	-	-	-
Kontributet nga dhe shpërndarjet për pronarët	-	-	-	-
Rritja në kapitalin aksionar	-	-	-	-
Gjithsej transaksionet me pronarët të regjistruara në kapital	-	-	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin				
Fitimi për vitin	-	-	5,841,933	5,841,933
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto e tatimit në fitim	-	(39,204)	-	(39,204)
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	(39,204)	5,841,933	5,802,729
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	17,000,000	(39,205)	17,756,475	34,717,270
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	17,000,000	(39,205)	17,756,475	34,717,270
Ndryshimet me aplikimin e SNRF 9 (shënimi 3, (p))	-	-	(1,674,437)	(1,674,437)
Gjendja e rivlerësuar më 01 Janar 2018	17,000,000	(39,205)	16,082,038	33,042,833
Transaksionet me pronarët të regjistruara direkt në kapital				
Kontributet nga dhe shpërndarjet për pronarët	-	-	-	-
Rritja në kapitalin aksionar	-	-	-	-
Gjithsej transaksionet me pronarët të regjistruara në kapital	-	-	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin				
Fitmi për vitin	-	-	4,370,402	4,370,402
Rivlerësimi i investimeve në letra me vlerë	-	(270,157)	-	(270,157)
Gjithsej fitimi gjithëpërfshirës për vitin	-	(270,157)	4,370,402	4,100,246
Gjendja më 31 dhjetor 2018	17,000,000	(309,362)	20,452,440	37,143,079

Shënimet e bashkangjitura prej 1 deri 29 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Banka Kombëtare Tregtare Kosovë Sh.a.

Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018
(në Euro)

Shënime	Për fund vitin 31 dhjetor 2018	Për fund vitin 31 dhjetor 2017
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative:		
Fitimi para tatimit për vitin	4,804,064	6,369,445
<i>Rregullimet për të barazuar ndryshimet në pasuritë neto me paratë e gatshme neto nga aktivitetet operative:</i>		
Shpenzimet e interesit	19 2,889,809	2,766,932
Të ardhura nga interesi	18 (16,641,523)	(15,314,246)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	10,11 641,750	711,670
Humbja nga heqja nga përdorimi i pasurive fikse	21 -	(150)
Shlyerjet e kredive të klientëve	9.2, 21 781,513	1,911,383
Provizionet për asetet financiare	9.2,24 2,835,886	365,552
Rrjedha e parasë nga fitimi operativ para ndryshimeve në pasuritë dhe detyrimet operative	(4,688,501)	(3,189,414)
<i>(Rritja)/Zvogëlimi në pasuritë operative:</i>		
Balancat e kufizuara me Bankën Qendrore	(2,700,896)	(3,930,980)
Plasmanet dhe balancat me banka	(851)	(13)
Kreditë për bankat	30,500,000	15,500,000
Kreditë për klientët	(39,570,088)	(28,303,167)
Të arkëtueshmet nga BKT Shqipëria	(8,769,331)	8,988,749
Pasuri të tjera	850,943	(2,625,889)
	(19,690,223)	(10,371,300)
<i>Rritja/(Zvogëlimi) në detyrimet operative:</i>		
Detyrimet ndaj bankave	49,377,178	15,026,134
Detyrimet ndaj klientëve	17,835,624	(923,854)
Shpenzimet e përlllogaritura dhe detyrime të tjera	(900,825)	(339,645)
	66,311,977	13,762,635
Interesi i paguar	(2,588,268)	(2,949,936)
Interesi i pranuar	16,161,336	15,284,280
Tatimet në të ardhura të paguara	(784,181)	(469,221)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative	54,722,140	12,067,044
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Blerja e letrave me vlerë	(37,478,626)	(35,186,143)
Të hyrat nga investimet në letra me vlerë	15,965,613	14,969,423
Blerja e pronave, pajisjeve dhe pasurive të paprekshme	(425,067)	(345,784)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese	(21,938,080)	(20,562,504)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
Pagesa e huamarrjeve	(1,820,000)	(1,820,000)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese	(1,820,000)	(1,820,000)
Rritja/(Zvogëlimi) neto në para dhe ekuivalentët e saj	30,964,060	(10,315,460)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të periudhës	6 15,051,531	25,366,991
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të periudhës	6 46,015,591	15,051,531

Shënimet e bashkangjitura prej 1 deri 29 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

1. Të përgjithshme

Banka Kombëtare Tregtare Kosovë Sh.a. ("Banka") është në pronësi të plotë të bankës shqiptare Banka Kombëtare Tregtare sh.a. ("BKT"). BKT- Kosova është regjistruar më 30 gusht 2007 në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës ("BQK"), për të vepruar si bankë në Republikën e Kosovës dhe është subjekt i rregulloreve të BQK-së .

Më 30 Prill, 2018, Banka Kombëtare Tregtare Dega në Kosovë ndryshoi statusin e saj nga dega e huaj në Shoqëri Aksionare. Licensa e saj bankare ndryshoi nga Banka Kombëtare Tregtare - Dega në Kosovë në Banka Kombëtare Tregtare Kosovë Sh.a

Banka ofron një gamë të gjerë të shërbimeve universale për ndërmarrjet private dhe shtetërore, dhe individët në Republikën e Kosovës. Burimi kryesor i financimit të Bankës janë depozitat, të cilat janë pranuar në formë të ndryshme duke përfshirë llogaritë rrjedhëse, depozitat me afat dhe pa afat, si në Euro ashtu edhe në valutë të huaj. BKT ofron një shumëllojshmëri të kredive të korporatave dhe të konsumit, karta debiti dhe krediti, shërbime përmes bankomatit, kanale alternative të sofistikuar, shërbime të kualifikuara ndërkombëtare bankare dhe produkte të ndryshme të thesarit.

Rrjeti i BKT Kosova përfshin 26 njësi. Shtatë njësi janë të vendosura në Prishtinë, dhe njësitë e tjera janë të vendosura në Prizren, Pejë, Gjiilan, Ferizaj, Mitrovicë, Gjakovë, Vushtri, Fushë Kosovë, Podujevë, Drenas, Rahovec, Viti dhe Lipjan, Aeroporti i Prishtinës dhe Skenderaj.

Numri i të punësuarve në fund të vitit 2018 ka qenë 358 (2017: 348).

2. Bazat e përgatitjes

(a) Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) ashtu siç janë lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike përveç pasurive financiare në dispozicion për shitje, të cilat janë të matura me vlerën e drejtë dhe pasurive të mbajtura për investim, të cilat poashtu janë të matura me vlerë të drejtë.

Për më tepër, për qëllime të raportimit financiar, matjet me vlerën e drejtë kategorizohen në Nivelin 1, 2 ose 3 në bazë të shkallës në të cilën të dhënat për matjen e vlerës së drejtë janë të vëzhgueshme dhe mund të kenë një efekt të rëndësishëm në tërësinë e tij, të cilat janë përshkruar si më poshtë:

- Niveli 1 përfshin të dhënat me çmimet e kuotuar (të pakorrigjuara) në tregjet aktive për pasuritë e njëjta ose detyrimet që ndërmarrja mund t'iu qaset në datën e matjes;
- Niveli 2 përfshin të dhënat përveç të dhënave me çmimet të kuotuar të përfshira në Nivelin 1, që janë të vëzhgueshme për pasuritë dhe detyrimet, qoftë në mënyrë direkte apo indirekt; dhe
- Niveli 3 të dhënat që janë të pa vëzhgueshme për pasuritë ose detyrimet.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Euro, e cila është edhe monedha funksionale e Bankës.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që menaxhmenti të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të pasurive, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen nga rishikimi. Informacionet mbi fushat kryesore të vlerësimit e pasigurive dhe mbi gjykimet kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt të rëndësishëm në vlerat kontabël në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimin 4 dhe 5.

3. Politika të rëndësishme kontabël

Politikat e kontabilitetit të paraqitura më poshtë janë aplikuar në vazhdimësi në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare.

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale të Bankës me kursin e këmbimit të momentit në datën e kryerjes së transaksionit. Pasuritë dhe detyrimet monetare në valutë të huaj në datën e raportimit janë rikonvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit momental në atë datë. Fitimi ose humbja nga zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar së monedhës funksionale në fillim të periudhës, rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të konvertuar me normën e këmbimit në fund të periudhës. Pasuritë dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë, rikonvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të çastit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi njihen në fitim ose humbje.

Pasuritë dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj, të cilat janë deklaruar me kosto historike, janë konvertuar me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

(b) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën efektive të interesit. Norma efektive e interesit është norma që skanton pagesat e vlerësuara të parave në të ardhmen dhe arkëtimet përgjatë jetës së pasurisë ose detyrimit financiar (ose, kur është e përshtatshme, një periudhë më të shkurtër) deri në vlerën kontabël të pasurisë ose detyrimit financiar. Gjatë llogaritjes së normës efektive të interesit, Banka vlerëson flukset monetare të ardhshme duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por jo humbjet e ardhshme të kredisë.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të arkëtuara që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot shtesë të lidhura drejtpërdrejtë me blerjen ose emetimin e një pasurie apo detyrimi financiar.

(c) Tarifat dhe komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet që janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv për një pasuri ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të ardhura tjera nga komisionet ose tarifat janë njohur posa shërbimet e lidhura me to kanë ndodhur. Ndërsa shpenzime të tjera nga tarifat dhe komisionet lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh ose shërbimesh të cilat njihen si shpenzime posa shërbimet të pranohen.

(d) Pagesat e bëra për qiranë

Pagesat e bëra për qiranë operative janë njohur në fitim dhe humbje në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së qirasë. Zbritjet nga qiraja njihen si pjesë përbërëse e totalit të shpenzimit të qirasë përgjatë kohëzgjatjes së qirasë. Pagesat e ardhshme të qirasë kontabilizohen duke rishikuar pagesat minimale të qirasë për periudhën e mbetur të qirasë, kur rregullimet dhe përshtatjet në qira konfirmohen.

(e) Tatimi aktual dhe i shtyrë në të ardhura

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe të shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në fitim ose humbje me përjashtim të pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose që konsiderohet se do të jenë të tilla në datën e raportimit, dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë është dhënë për diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës neto kontabël të pasurive dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë është matur në norma të tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato të ndryshojnë, në bazë të ligjeve të cilat janë miratuar ose priten të miratohen në datën e raportimit.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë Banka merr parasysh ndikimin e pozicioneve të pasigurta tatimore dhe nëse mund të ketë taksa dhe interes shtesë. Banka beson se përlogaritjet e saj për detyrimet tatimore janë të mjaftueshme për të gjitha vitet tatimore bazuar në vlerësimin e saj të shumë faktorëve, duke përfshirë interpretimet e ligjit të taksave dhe përvojës së mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë një seri të gjykimeve rreth ngjarjeve të ardhshme. Informata të reja mund të vinë në dispozicion që të ndikojnë te Banka për të ndryshuar vendimin e saj në lidhje me mjaftueshmërinë e detyrimeve ekzistuese tatimore; ndryshime të tilla të detyrimeve tatimore do të ndikojnë në shpenzimet e tatimit në periudhën që një përcaktim i tillë është bërë.

Tatimi i shtyrë - pasuri njihet deri në masën që është e mundur që fitimi i ardhshëm i tatueshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit mund të përdoret pasuria e tillë. Tatimi i shtyrë - pasuri rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet në atë masë që përfitimet nga pasuria e tillë nuk është e mundur më të realizohen.

(f) Pasuritë dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Banka fillimisht njeh kreditë, depozitat, instrumentat e borxhit të emetuara dhe detyrimet vartëse në datën në të cilën ato janë krijuar. Blerjet dhe shitjet e rregullta të pasurive financiare njihen në datën e tregtimit në të cilën Banka zotohet për të blerë ose shitur pasurinë. Të gjitha pasuritë dhe detyrimet tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Banka bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Një pasuri ose detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë plus (për një pozicion i cili nuk matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) kostot e transaksionit që i atribuohen direkt blerjes apo emetimit të tij.

(ii) Ç'regjistrimi

Banka ç'regjistron një pasuri financiare kur të drejtat kontraktuale të flukseve monetare nga pasuria financiare mbarojnë, ose kur transferon të drejtat për të marrë rrjedhjet e kontraktuara të parasë mbi pasurinë financiare në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë në fjalë janë transferuar. Çdo interes në pasuritë financiare të transferuara që është krijuar ose mbajtur nga Banka njihet si një pasuri apo detyrim i veçantë.

Banka ç'regjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ndërprerë apo kanë përfunduar. Banka merr pjesë në transaksione përmes të cilave transferon pasuri të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban të gjitha ose kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pasurisë së transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha ose kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet mbahen, atëherë pasuritë e transferuara nuk ç'regjistrohen nga pasqyra e pozicionit financiar. Transferimi i pasurive të tilla të cilat mbahen të gjitha ose kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet përfshin, për shembull, huadhënien dhe transaksionet e riblerjes.

Kur pasuritë i shiten një pale të tretë me një normë totale kthimi të njëkohshme swap mbi pasurinë e transferuar, transaksioni kontabilizohet si një transaksion i sigurtuar i financimit i ngjashëm me transaksionet e riblerjes. Në transaksione në të cilat Banka as nuk mban dhe as nuk transferon kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të një pasurie financiare, e ç'regjistron pasurinë nëse nuk mban kontroll mbi të. Të drejtat dhe detyrimet e mbajtura nga transferi janë të njohura veçmas si pasuri dhe detyrime, sipas rrethanave në menyrën më të përshtatshme. Në transferimet në të cilën kontrolli mbi pasurinë ruhet, Banka vazhdon të njohë pasurinë në masën e përfshirjes së saj të vazhdueshme në lidhje me pasurinë, e përcaktuar kjo nga koha gjatë së cilës Banka është e ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e pasurisë së transferuar.

Në disa transaksione, Banka mban detyrimin për të ofruar shërbime për pasurinë financiare të transferuar në shkëmbim për një tarifë. Aktiv i transferuar ç'regjistrohet tërësisht nëse plotëson kriteret e ç'regjistrimit. Një pasuri ose detyrim njihet për kontratën e shërbimit, në varësi të faktit nëse tarifa e shërbimit është më shumë se mjaftueshëm (pasuri) ose është më pak se mjaftueshëm (detyrim) për kryerjen e shërbimit.

Banka fshin kredi të caktuara kur ato vlerësohen si të pambledhshme.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(iii) Klasifikimi dhe matja fillestare e pasurive financiare

Të gjitha pasuritë financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të përmirësuar për kostot e transaksionit (aty ku është e aplikueshme). Pasuritë financiare, të tjera nga ato të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse klasifikohen në këto kategori :

- kostoja e amortizuar
- vlera e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH)
- vlera e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ).

Klasifikimi përcaktohet nga:

- modelin e biznesit të njësisë ekonomike për menaxhimin e pasurive financiare.
- karakteristikat e rrjedhës së pasurisë financiare të kontraktuar.

Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me aktivet financiare njihen në fitim ose humbje.

- Vlerësimi nëse rrjedhat e parasë janë vetëm pagesa kontraktuale të principalit dhe interesit (VPPI)

Sipas standardit të ri, njëra nga kushtet që një pasuri financiare të klasifikohet nën kategorinë “Kosto e amortizuar” apo “Vlera e drejtë nëpërmjet fitimi apo humbjes (VDNFH)” është që kushtet kontraktuale të pasurisë financiare të jenë të specifikuar në datat e rrjedhës së parasë që janë vetëm pagesa të principalit dhe interes mbi vlerën e mbetur të principalit. Banka ka kryer testin e VPPI dhe ka përcaktuar modelet e biznesit për pasuritë e saj financiare.

- Vlerësimi i modelit të biznesit

Janë tre modele të biznesit sipas SNRF 9 – ‘Mbahet për tu arkëtuar (“MPA”)’, ‘Mbahet për tu arkëtuar dhe për tu shitur (“MASH”)’ dhe ‘Të tjera (“Tjera BM”)’

1. Sipas modelit “MPA” rrjedhja e parasë rezultojnë nga mbledhja e pagesave të kontraktuara. Nëse një product VPPI është “MPA”, ai matet me koston e amortizuar.
2. Sipas modelit “MASH” rrjedhja e parasë rezultojnë nga mbledhja e pagesave të kontraktuara si dhe nga shitja e pasurive financiare. Nëse një produkt VPPI është “MASH”, ai matet me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ).
3. Modelet tjera të biznesit janë ato që nuk janë as MPAs as MASH. Një shembull është një model biznesi në të cilin qëllimi kryesor është tregtimi ku mbledhja e pagesave kontraktuale nuk është pjesë përbërëse e modelit. Nëse një produkt (VPPI apo jo) mbahet nën “Të tjera” dhe matet me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDNFH)

Banka ka vlerësuar modelin e biznesit për pasuritë e saj financiare si në vijim:

Thesari

Pasuritë e thesarit përbëhen nga paratë e gatshme ose ekuivalentët e parasë, obligacionet qeveritare, letrat me vlerë si Eurobonde, obligacione dhe certifikata.

Investimet në letra me vlerë llogariten në bazë të klasifikimit të tyre si të mbajtura deri në maturim (“TMM”), në dispozicion për shitje (“GJPSH”) dhe në disa raste si të mbajtura për tregtim (“TMT”).

Modeli i biznesit të Bankës sipas SNRF 9 është:

- “MPA” për produktet TMM. Këto produkte duhet të matet me koston e amortizuar;
- “MASH” për produktet GJPSH.Këto produkte duhet të maten në VDATGJ; dhe
- “Të tjera” për produktet TMT dhe duhet të maten në VDNFH.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(iii) Klasifikimi dhe matja fillestare e pasurive financiare (vazhdim)

Individë

Pasuritë e bankikut individual përbëhet nga produkte të ndryshme financuese për individë si: kreditë hipotekare, konsumatore, për renovimin e shtëpive, makinave dhe kartat e kreditit. Këto produkte janë pasuri financiare jo-derivative që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv financiarë, të cilat mbahen për arkëtimin e rrjedhave të ardhshme të pagesave të kontraktuaratë principalit dhe interesit.

Vlera e drejtë e pasurive të bankikut individual nuk është aspekt kritik në menaxhimin e portofolit të bankës. Modeli i biznesit për Banka sipas SNRF 9 është "MPA" dhe kreditë individuale duhet të maten me koston e amortizuar.

Korporatë

Pasuritë e bankikut të korporatave përbëhen nga produkte të ndryshme financuese për biznese si: kreditë me para të gatshme, kreditë jo-kesh, kreditë bujqësore, projektet dhe financimet e strukturuar, kartat e kreditit të biznesit). Këto produkte janë pasuri financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv të cilat mbahen për arkëtimin e rrjedhave të parave të principalit dhe interesave. Vlera e drejtë e pasurive të Korporatës nuk është një aspekt kritik në menaxhimin e portofolit të bankës. Modeli i biznesit për Banka sipas sipas SNRF 9 është "MPA" dhe kreditë biznes maten me koston e amortizuar.

(iv) Klasifikimi – (periudhat krahasuese)

Pasuritë financiare klasifikohen në kategoritë e specifikuar si më poshtë: pasuritë financiare të mbajtura për tregtim, investimet e mbajtura deri në maturim, pasuritë financiare "në dispozicion për shitje" (GJPSH) dhe "kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme". Klasifikimi varet nga natyra dhe qëllimi i pasurive financiare dhe përcaktohet në kohën e njohjes fillestare. Të gjitha blerjet ose shitjet e rregullta të pasurive financiare njihen dhe ç' regjistrohen në bazë të datës së tregtimit. Blerjet ose shitjet e rregullta janë blerjet ose shitjet e pasurive financiare që kërkojnë shpërndarjen e aseteve brenda afatit të përcaktuar me rregullore ose konventë në treg.

(v) Matja e mëpasshme e pasurive financiare

Pasuritë financiare në koston e amortizuar

Pasuritë financiare maten në koston e amortizuar nëse pasuritë plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk janë përcaktuar si VDNFH):

- ato mbahen në kuadër të një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e mjeteve financiare dhe arkëtimin e rrjedhave të parasë.
- kushtet kontraktuale të pasurive financiare krijojnë rrjedha të parasë që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit për shumën kryesore të principalit të mbetur.

Pas njohjes fillestare, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Zbritja nuk është përfshirë sepse efekti i zbritjes është jomaterial. Paratë e gatshme dhe ekuivalentët e saj, kreditë dhe shumica e të arkëtueshmeve të bankës bien në këtë kategori të instrumenteve financiare, po ashtu edhe obligacionet qeveritare dhe instrumentet të cilat më parë ishin klasifikuar si të mbajtura deri në maturim sipas SNK 39.

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDNFH)

Pasuritë financiare që mbahen në një model biznesi të ndryshëm nga "mbahet për të arkëtuar" ose "mbahet për të arkëtuar dhe shitur" kategorizohen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes. Pasuritë financiare të modelit të biznesit, në të cilin rrjedhat e parasë nuk janë vetëm nga interesi dhe principalit, llogariten në VDNFH. Të gjitha instrumentet financiare derivative bien në këtë kategori, përveç atyre të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse. Kjo kategori përmban edhe investimet në capital. Në vitin aktual, vlera e drejtë është përcaktuar në përputhje me SNRF 9 e cila nuk lejon matjen me kosto. Pasuritë në këtë kategori maten me vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në pasqyrën e të ardhurave. Vlera e drejtë e pasurive financiare në këtë kategori përcaktohet duke i'u referuar transaksioneve aktive të tregut ose duke përdorur një teknikë vlerësimi aty ku nuk ekziston një treg aktiv Banka konstatoi se në periudhën aktuale vlera e drejtë e këtyre investimeve përafrohet me vlerën e tyre kontabël. Obligacionet e qeverisë të Bankës të klasifikuar më parë si të mbajtura për tregtim sipas SNK 39 bien në këtë kategori.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(v) *Matja e mëpasshme e pasurive financiare (vazhdim)*

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera përmbledhëse (VDATGJ)

Banka llogaritë pasuritë financiare në VDATGJ nëse pasuritë plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- ato mbahen në një model biznesi objektiv i të cilit është "të mbahet për tu arkëtuar" e rrjedhat e parasë dhe ta shes.

- kushtet kontraktuale të pasurive financiare që krijojnë rrjedhat e parasë që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit për principalin e mbetur.

Çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera përmbledhëse (ATGJ) do të riciklohet pas mosnjohjes së aktivitetit. Bono qeveritare të bankës, letrat me vlerë thesarit dhe bonot e thesarit, obligacionet e korporatave, nota premtuese, letrat me vlerë të mbështetura në asete dhe portofoli i kapitalit i klasifikuar si e disponueshme për shitje sipas SNK 39, bien në këtë kategori.

(vi) *Kompensimi*

Pasuritë dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë, dhe vetëm atëherë, kur Banka ka të drejtën ligjore për të kompensuar shumat dhe synon ose të shlyejë mbi një bazë neto, ose të shes aktivin dhe njëkohësisht të shlyejë detyrimin. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si ato në aktivitetin tregtues të Bankës.

(vii) *Matja e kostove të amortizimit*

Kostoja e amortizuar e një pasurie ose detyrimi financiar është vlere me të cilën pasuria ose detyrimi financiar matet kur njihet fillimisht, duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën efektive të interesit të çdo difference ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe shumës së maturimit, minus çdo zbritje për efekt rënie në vlerë.

(viii) *Matja e vlerës së drejtë*

Vlera e drejtë është shuma me të cilën një pasuri mund të shkëmbehet, ose një detyrim të shlyhet, midis palëve të vullnetshme që kanë informatat e duhura, në një transaksion në kushte të tregut në datën e matjes.

Kur është e mundur, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg quhet aktiv në qoftë se çmimet e kuotuar janë të gatshme dhe rregullisht të disponueshme dhe paraqesin transaksionet aktuale të tregut si dhe rregullisht ndodhin në kushte të lira tregu.

Nëse tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, Banka përcakton vlerën e drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë përdorimin e transaksioneve më të fundit të kryera midis palëve të vullnetshme që kanë informacionin e duhur (nëse ka), duke iu referuar vlerës së drejtë aktuale të instrumenteve tjera që në thelb janë të njëjtë, analizat e flukseve monetare të skontuara dhe modelet e çmimeve të opsioneve. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përdor maksimumin e faktorëve të tregut, mbështetet sa më pak të jetë e mundur në vlerësimet specifike të Bankës, përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në përcaktimin e çmimit, dhe është në përputhje me metodologjitë ekonomike të pranura për vlerësimin e instrumentave financiarë. Faktorët për teknikat e vlerësimit paraqesin në mënyrë të arsyeshme pritshmëritë e tregut dhe matjet e faktorëve të rreziqeve të trashëguara në instrumentet financiare. Banka klasifikon metodat e vlerësimit dhe i teston ato për vlefshmërinë duke përdorur çmimet nga transaksionet aktuale të tregut për të njëjtin instrument ose të dhëna të tjera të disponueshme dhe të vëzhgueshme në treg.

Kur një pasuri është blerë ose një detyrim merret në një transaksion këmbimi për atë pasuri ose detyrim, çmimi i transaksionit është çmimi i paguar për të blerë pasurinë ose për të marrë atë për të marrë detyrimin (çmimi i hyrjes). Në të kundërt, vlere e drejtë e pasurisë ose detyrimit është çmimi që do të merret për të shitur pasurinë ose për të paguar për transferimin e detyrimit (çmimi i daljes)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(viii) Matja e vlerës së drejtë

Në shumë raste çmimi i transaksionit është i barabartë me vlerën e drejtë (që mund të jetë rasti kur në datën e transaksionit transaksioni për të blerë një aktiv ndodh në treg në të cilin asetit do të shitet). Gjatë përcaktimit nëse vlera e drejtë në njohjen fillestare është e barabartë me çmimin e transaksionit, Banka merr në konsideratë faktorët specifikë për transaksionin dhe pasurinë ose detyrimin. Kur çmimi i transaksionit siguron evidencën më të mirë të vlerës së drejtë në njohjen fillestare, instrumenti financiar fillimisht matet me çmimin e transaksionit dhe çdo diferencë midis këtij çmimi dhe shumës së fituar fillimisht nga një vlerësim model njihet më pas në fitim ose humbje, varësisht nga individit faktet dhe rrethanat e transaksionit, por jo më vonë se kur vlerësimi mbështetet plotësisht nga të dhënat e tregut të vëzhgueshëm ose transaksioni është i mbyllur.

(ix) Rënia në vlerë e pasurive financiare

Kërkesat për provizionet sipas SNRF 9 përdorin më shumë informacione prospektive që t'i njohin humbjet e pritura të kreditit – 'Modeli i humbjes së pritshme kreditore (HPK)'. Kjo zëvendëson SNK39 'modelin e humbjeve të ndodhura'. Instrumentet në kuadër të fushëveprimit të kërkesave të reja përfshinin kreditë dhe instrumente të tjera financiare të borxhit të matura me koston e amortizuar dhe VDATGJ, llogaritë e arkëtueshme, kontratat e njohura dhe të matura sipas SNRF 15, angazhimet e huasë dhe disa kontrata të garancisë financiare (për emetuesin) që nuk janë të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Njohja e humbjeve kreditore nuk është më e varur nga identifikimi i një ngjarjeje të humbjes së kredisë nga Banka por në vend të kësaj, Banka konsideron një gamë më të gjerë informacionesh gjatë vlerësimit të rrezikut të kredisë dhe matjes së humbjeve të pritshme të kredisë, duke përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetshme që ndikojnë në arkëtueshmërinë e pritshme të rrjedhave të parasë të ardhshme të instrumentit.

Në zbatimin e kësaj qasjeje prospektive, bëhet një dallim midis:

- instrumentet financiare që nuk janë përkeqësuar ndjeshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare ose që kanë rrezik të ulët të kredisë ('Faza 1')
- instrumentet financiare që janë përkeqësuar ndjeshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare dhe që rreziku i kredisë, i të cilit nuk është i ulët ('Faza 2').

'Faza 3' do të mbulonte aktivet financiare që kanë dëshmi objektive të provizionimit në datën e raportimit.

'Humbjet e pritshme të kreditore 12 mujore 'njihen për kategorinë e parë, ndërsa' humbjet e pritshme të kreditit gjatë tërë jetëgjatësisë së saj' njihet për kategorinë e dytë.

Matja e humbjeve të pritshme të kredive përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kredisë përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

(x) Rënia në vlerë e pasurive financiare (periudhë krahasuese)

Në vitin paraprak, rënia në vlerë e pasurive financiare u bazua në modelin e humbjeve të ndodhura. Banka ka vlerësuar nëse ka pasur dëshmi objektive se pasuritë financiare që nuk mbarten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes janë provizionuar. Pasuritë financiare u provizionuan kur dëshmitë objektive treguan se një ngjarje humbjeje kishte ndodhur pas njohjes fillestare të pasurisë dhe se ngjarja e humbjes ndikon në rrjedhat e ardhshme të parasë së aktivit që mund të vlerësoheshin me besueshmëri.

Banka konsideromte dëshmi të provizionimit për huatë dhe letrat me vlerë të investimit të mbajtura deri në maturim si në një pasuri specifike dhe në nivelin kolektiv. Të gjitha kreditë me vlerë të konsiderueshme dhe letrat me vlerë të investimit të mbajtura deri në maturim u vlerësuan për provizionime specifike. Të gjitha kreditë me vlerë të konsiderueshme dhe të letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim, si jo të provizionueshme në mënyrë specifike, atëherë u provizionuan kolektivisht për ndonjë provizionim të ndodhur, por të pa identifikuar ende.

Shënimet mbi pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018

(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohet ndryshe)

Huatë, avanset dhe investimet në letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim që nuk ishin individualisht të rëndësishme u vlerësuan kolektivisht për provizionim duke i grupuar së bashku huatë dhe letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim me karakteristika të ngjashme të rrezikut.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(x) Rënia në vlerë e pasurive financiare (periudhë krahasuese) (vazhdim)

Humbjet nga provizionimi i pasurive të mbajtura me koston e amortizuar janë matur si diferencë midis vlerës kontabël të aktivitetit financiar dhe vlerës aktuale të rrjedhave të ardhshme të parasë, të parashikuara, të skontuara me normën e interesit efektiv të pasurisë. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe kontabilizohen në një llogari kundrejt huave. Interesi mbi aktivin e provizionuar vazhdon të njihet nëpërmjet zbritjes të pandryshueshme. Kur një ngjarje e mëvonshme shkakton zvogëlimin e shumës së humbjes nga provizionimi, ulja në humbjen nga zhvlerësimi kthehet në pasqyrën e të ardhurave.

Humbjet nga provizionimi i letrave me vlerë në dispozicion për shitje u njohën duke transferuar humbjen kumulative që ishte njohur drejtpërdrejt në të ardhurat e tjera përmbledhëse në fitim ose humbje. Humbja kumulative e riklasifikuar nga të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse në fitim ose humbje ishte diferenca midis koston së blerjes, shlyerjet e principalit dhe amortizimet, dhe vlerës aktuale të drejtë, minus çdo humbje nga zhvlerësimi e njohur më parë në fitim ose humbje. Ndryshimet në provizionet që i atribuohen vlerës në kohë janë pasqyruar si një përbërës i të ardhurave nga interesi. Nëse në një periudhë pasuese vlera e drejtë e një letre me vlerë në dispozicion për shitje të provizionuar është në rritje dhe rritja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pasi humbja nga provizionimi ishte njohur në fitim ose humbje, humbja nga provizionimi u anulua, me shumën e anulimit të njohur në fitim ose humbje.

(xi) Klasifikimi dhe matja e detyrimeve financiare

Duke qenë se kontabilizimi i detyrimeve financiare mbetet kryesisht i njëjtë sipas SNRF 9 krahasuar me SNK 39, detyrimet financiare të Bankës nuk kanë qenë të ndikuara nga miratimi i SNRF 9. Detyrimet financiare të Bankës përfshijnë depozitat e klientëve, huatë nga bankat dhe institucionet e tjera financiare, borxhi i varur dhe detyrime të tjera të pagueshme. Detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë dhe kur është e aplikueshme, përshtaten për kostot e transaksionit, përveç nëse Banka përcakton një pasiv financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Më pas, detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç derivativave dhe detyrimeve financiare të përcaktuara në VDNFH, të cilat mbahen më pas me vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në pasqyrën e të ardhurave (përveç instrumenteve financiare derivative të cilat janë të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse). Të gjitha pagesat lidhur me interesin dhe, nëse është e zbatueshme, ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti që raportohen në fitim ose humbje përfshihen në kostot financiare ose të ardhurat financiare.

(xii) Instrumentet financiare derivative dhe kontabiliteti mbrojtës

Banka aplikon kërkesat e reja të SNRF 9 në kontabilitetin mbrojtës në mënyrë prospektive.

Instrumentet financiare derivative llogariten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes (VDNFH) me përjashtim të derivateve të përcaktuara si instrumente mbrojtës në marrëdhëniet mbrojtëse të rrjedhës së parasë, të cilat kërkojnë një trajtim të veçantë kontabël. Për t'u kualifikuar për kontabilitetin mbrojtës, marrëdhënia mbrojtëse duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e mëposhtme:

- Ekziston një marrëdhënie ekonomike midis zërit të mbrojtur dhe instrumentit mbrojtës
- Efekti i rrezikut kreditor nuk dominon ndryshimet e vlerës që rrjedhin nga ajo marrëdhënie ekonomike
- Treguesi mbrojtës i marrëdhënies së mbrojtur "hedging" është i njëjtë me atë që rezulton nga sasia e asetit të mbrojtur që njësia ekonomike aktualisht mbron dhe sasia e instrumentit mbrojtës që njësia ekonomike aktualisht përdor për të mbrojtur atë sasi të elementit të mbrojtur.

Të gjitha instrumentet financiare derivative të përdorura për kontabilitetin mbrojtës njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe raportohen më pas me vlerën e drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar. Në masën që mbrojtja është efektive, ndryshimet në vlerën e drejtë të derivativëve të përcaktuar si instrumente mbrojtëse në mbrojtjen e rrjedhës së parave njihen në të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse dhe përfshihen në rezervën

Shënimet mbi pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018

(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohet ndryshe)

mbrojtëse të rrjedhës së pasasë në kapital. Çdo mosfunksionim në marrëdhënien mbrojtëse njihet menjëherë në fitim ose humbje.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(xii) Instrumentet financiare derivative dhe kontabiliteti mbrojtës (vazhdim)

Në kohën kur elementi i mbrojtur ndikon në fitimin ose humbjen, çdo fitim ose humbje e njohur më parë në të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse riklasifikohet nga kapitali neto në pasqyrën e të ardhurave dhe paraqitet si një riklasifikim brenda të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse. Megjithatë, nëse një pasuri ose detyrim jofinanciar është njohur si rezultat i transaksionit të mbrojtur, fitimet dhe humbjet e njohura më parë në të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse përfshihen në matjen fillestare të pjesës së mbrojtur. Nëse një transaksion paraparë nuk pritet të ndodhë, çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera gjithpërfshirëse bartet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave. Nëse marrëdhënia mbrojtëse mbaron të përmbushë kushtet e efektivitetit, kontabiliteti mbrojtës ndërpritet dhe fitimi ose humbja në fjalë mbahen në rezervën e kapitalit derisa të ndodhë transaksioni paraparë.

(g) Paraja dhe ekuivalentët e pasasë

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë kartëmonedhat, monedhat, balancat e pakushtëzuara të mbajtura në Bankën Qendrore si dhe pasuritë financiare likuide me afat maturimi më pak se tre muaj, të cilat janë subjekt i një rreziku të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e drejtë, dhe përdoren nga Banka në menaxhimin e zotimeve afatshkurtra. Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

(h) Derivatet e mbajtura për qëllime të administrimit të rrezikut

Derivatet e mbajtura për qëllime të administrimit të rrezikut përfshijnë të gjitha aktivet dhe detyrimet derivative të cilat nuk klasifikohen si pasuri ose detyrime të tregtueshme. Derivatet e mbajtura për qëllime të administrimit të rrezikut maten me vlerën e drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar.

(i) Kreditë

Kreditë janë pasuri financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe Banka nuk ka ndërmend t'i shesë menjëherë ose në të ardhmen e afërt. Kur Banka blen një pasuri financiare dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për ta rishitur këtë pasuri (ose një pasuri kryesisht të ngjashme) me një çmim fiks në një datë të ardhshme ("riblerje të anasjellta"), marrëveshja kontabilizohet si një kredi apo paradhënie, dhe pasuria nuk paraqitet në pasqyrat financiare të Bankës. Kreditë fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kosto direkte që lidhen me transaksionin, dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën efektive të interesit, përveç në rastet kur Banka vendos të mbajë kreditë me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes siç përshkruhet në politikën kontabël 3 (g), (iii).

(j) Pronat, pajisjet dhe pasuritë paprekshme

(i) Njohja dhe matja

Zërat e pronës dhe pajisjeve paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Kosto përfshinë shpenzimet e lidhura drejtpërdrejtë me blerjen e pasurisë.

Kur pjesë të një zëri të pronës dhe pajisjeve kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si pozicione të veçanta (përbërësit kryesorë) të pronës dhe pajisjeve.

(ii) Shpenzimet pasuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të pronës dhe pajisjeve njihet në vlerën kontabël të pasurisë nëse është e mundur që benefitet e ardhshme ekonomike të trupëzuara përbrenda pjesës do të rrjedhin në Bankë dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Vlera e mbetur e pjesës së zëvendësuar ç'regjistrohet. Kostot e përditshme të mirëmbajtjes së pronës dhe pajisjeve njihen në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(j) Pronat, pajisjet dhe pasuritë paprekshme (vazhdim)

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave në bazë lineare përgjatë kohës së vlerësuar të përdorimit të secilës njesie të pronës dhe pajisjeve. Toka nuk zhvlerësohet.

Jetëgjatësia e vlerësuar për periudhën aktuale dhe atë të kaluar është si më poshtë:

- | | |
|---------------------------------------|---|
| • Përmirësimet e objekteve me qera | Përmirësimet e objekteve me qera zhvlerësohen përgjatë periudhës së kontratës së qirasë ose jetëgjatësisë së mbetur |
| • Automjete dhe makineri | 5 vite |
| • Mobilje dhe orendi | 5 vite |
| • Kompjuterat dhe pajisje elektronike | 5 vite |

Metodat e zhvlerësimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rishikohen në datën e raportimit. **(iv) Pasuritë e paprekshme**

Pasuritë e paprekshme maten fillimisht me kosto. Pasuritë e paprekshme njihen nëse është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme që i atribuohen pasurive do të rrjedhin në ndërmarrje; dhe kostoja e aktivit mund të matet në mënyrë të besueshme. Pas njohjes fillestare, pasuritë e paprekshme maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga amortizimi. Pasuritë e paprekshme amortizohen në bazë të metodës lineare mbi vlerësimin më të mirë të jetës së tyre të dobishme, nëse ka. Pasuritë e paprekshme përbëhen nga licencat e softuerit dhe amortizohen në baza lineare përgjatë 3 viteve.

(k) Pasuritë e fituara përmes procesit ligjor (kolaterali i riposeduar)

Kolaterali i riposeduar përfaqëson asetet jofinanciare të blera nga Banka në shlyerjen e kredive të prapambetura. Aktivitet fillimisht njihen me vlerën e drejtë kur janë blerë dhe përfshihen në objektet dhe pajisjet, aktivitet e tjera ose inventarët brenda aktiveve të tjera në varësi të natyrës së tyre dhe qëllimit të Bankës në lidhje me rikuperimin e këtyre aktiveve dhe më pas janë rimatuar dhe llogariten në përputhje me politikat kontabël për këto kategori të aktiveve. Banka zbaton politikën e saj kontabël për aktivitet afatgjatë që mbahen për shitje ose grupet e nxjerrë jashtë përdorimit në kolateralin e riposeduar kur kushtet përkatëse për këtë klasifikim plotësohen në fund të periudhës raportuese.

Kolaterale të riposeduara nga Banka përfaqësojnë kolateralin e disa kredive të pakthyeshme, pronësia e së cilës është marrë nga Banka. Banka ka themeluar një Komision për Shitjen e Pasurisë, përgjegjës për asgjësimin e këtyre pasurive. Këto aktive trajtohen si aktive të mbajtura për shitje dhe maten me vlerën e drejtë. Vlera e drejtë e këtyre aktiveve në datën e raportimit përcaktohet duke iu referuar çmimeve aktuale të tregut.

(l) Rënia në vlerë e pasurive jo financiare

Vlera kontabël e pasurive jo financiare të Bankës, përveç tatimit të shtyrë si pasuri, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka dëshmi për rënie në vlerë. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e pasurisë.

Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një pasurie tejkalon vlerën e rikuperueshme. Një njësi e cila gjeneron rrjedhje të parasë i takon grupit të pasurive që gjenerojnë rrjedhje të parasë e të cilat janë të pavarura nga pasuritë dhe grupet tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga rënia në vlerë, të njohura për pasuritë që krijojnë rrjedhje të parasë, alokohen së pari për të zvogëluar vlerën kontabël të njdonjë goodwill dhe më pas për të zvogëluar vlerën kontabël të pasurive të tjera në njësi (grup njësisë) në mënyrë proporcionale. Shuma e rikuperueshme e një pasurie është më e madhe se vlera e saj në përdorim dhe vlera e drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për pasurinë. Humbjet nga rënia në vlerë të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për të parë nëse humbja është zvogëluar apo nuk ekziston më.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(l) Rënia në vlerë e pasurive jo financiare (vazhdim)

Humbja nga rënia në vlerë kthehet nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e pasurisë nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, në qoftë se nuk ka humbje që është njohur nga rënia në vlerë.

(m) Depozitat dhe huazimet

Depozitat dhe huazimet janë pjesë e burimeve të financimit të Bankës.

Kur Banka shet një pasuri financiare dhe njëkohësisht hyn në një marrëveshje për të riblerë këtë pasuri (ose një pasuri të ngjashme) me një çmim fiks në një datë të ardhshme ("riblerje" ose "huadhënie mjeteshe"), marrëveshja kontabilizohet si një depozitë, dhe vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Depozitat dhe huazimet maten fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e lidhura drejtëpërdrejt me transaksionin, dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(n) Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që një rrjedhje e përfitimeve ekonomike do të kërkohej për të shlyer detyrimin. Provizionet janë përcaktuar duke skontuar flukset e ardhshme të parasë me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe, kur është e mundshme, rrezikun specifik të detyrimit.

Një provizion për ristrukturimin njihet kur Banka ka miratuar një plan të detajuar dhe formal ristrukturimi, dhe ristrukturimi ose ka filluar ose është shpallur publikisht. Shpenzimet e ardhshme operative nuk janë dhënë. Provizioni për kontrata e mëdha njihet kur përfitimet e pritura që do të rrjedhin në Bankë nga një kontratë e tillë janë më të ulëta se kostoja e pashmangshme e realizimit të detyrimeve sipas kontratës. Provizioni matet me vlerën aktuale të koston së pritshme të ndërprerjes së kontratës ose koston së pritshme neto të vazhdimin të kontratës, cilado të jetë më e ulët. Para se të njihet një provizion, Banka njeh çdo humbje nga rënia në vlerë e pasurive të lidhura me atë kontratë.

(o) Përfitimet e punëtorëve

(i) Planet e kontributeve të përcaktuara

Detyrimet për kontribute ndaj planeve të pensioneve me kontribute të përcaktuara njihen si shpenzim në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Banka paguan kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme që sigurojnë përfitimet pensionale për punëtorët kur dalin në pension. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Kosovë sipas planit të pensioneve me kontribute të përcaktuara.

(ii) Përfitimet afatshkurtëra

Detyrimet për përfitime afatshkurtra maten mbi baza të pazbritshme dhe njihen si shpenzime kur shërbimi i ndërlidhur kryhet. Një provizion njihet për shumën që pritet të paguhet në para si bazë e bonusit afatshkurtër ose të fitimit, nëse Banka ka një detyrim aktual ose mbi një bazë konstruktive për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimeve të kaluara të ofruara nga punonjësi dhe detyrimi mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(p) Standardet e reja të miratuara më 1 janar 2018

SNRF 15 'Të hyrat nga kontratat me klientët'

SNRF 15 paraqet kërkesa të reja për njohjen e të ardhurave, duke zëvendësuar SNRF 18 'Të Ardhurat', SNK 11 'Kontratat e Ndërtimit' dhe disa Interpretime të lidhura me të ardhurat. SNRF 15 'Të Ardhurat nga Kontratat me Konsumatorët' dhe Sqarimet në SNRF 15 Të Ardhurat nga Kontratat me Konsumatorët (në tekstin e mëtejshëm "SNRF 15") zëvendësojnë SNK 18 'Të Ardhurat', SNK 11 'Kontratat e Ndërtimit' dhe disa të ardhura lidhur me Interpretimet. Standardi i ri përcakton një model të njohjes së të ardhurave nga kontrolli dhe ofron udhëzime shtesë në shumë fusha që nuk mbulohen në detaje sipas SNRF-ve ekzistuese, duke përfshirë mënyrën e llogaritjes së marrëveshjeve me detyrime të shumëfishta të performancës, çmimeve të ndryshueshme, të drejtave të rimbursimit të klientit, opsioneve të riblerjes së furnitorëve dhe të tjera kompleksitetin e zakonshëm.

Zbatimi i këtij udhëzimi të ri nuk ka ndikim të rëndësishëm në kohën ose shumën e të ardhurave të njohura nga Banka në çdo vit. Sikur zbatimi të rezultojë në një ndikim domethënës, standardi i ri do të zbatohet në mënyrë retrospektive pa riparaqitje, me efektin kumulativ të aplikimit fillestar të njohur si një rregullim në bilancin fillestar të fitimeve të mbajtura më 1 janar 2018.

SNRF 9 "Instrumentet Financiare"

SNRF 9 zëvendëson SNK 39 'Instrumentet Financiare: "Njohja dhe Matja"'. Ai bën ndryshime të mëdha në udhëzimet e mëparshme për klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare dhe paraqet një model të 'humbjes së pritshme të kredisë' për zhvlerësimin e pasurive financiare.

Gjatë miratimit të SNRF 9, Banka ka aplikuar lehtësim në tranzicion dhe ka vendosur të mos ripërtërijë periudhat e mëparshme. Diferencat që rrjedhin nga miratimi i SNRF 9 në lidhje me klasifikimin, matjen dhe zhvlerësimin njihen në fitimet e pashpërndara.

Banka ka adoptuar politika të reja kontabël, duke zbatuar kërkesat e SNRF 9, në fuqi që nga 1 janari 2018. Banka gjithashtu ka vlerësuar ndikimin e SNRF 9 në asetet e saja financiare dhe ka përmirësuar dhe përshtatur aplikacionet ekzistuese të biznesit dhe ka adaptuar rregulloret e reja për të përfshirë kërkesat e SNRF 9.

Banka ka vlerësuar ndikimin e SNRF 9, në fushat e mëposhtme:

1) Klasifikimi i pasurive i financiare

Klasifikimi dhe matja e instrumenteve financiare më ose pas 1 janarit 2018 bazohet në kritere të reja që marrin parasysh rrjedhat e parave të kontraktura të instrumenteve financiare dhe modelin e biznesit në të cilin ato menaxhohen. SNRF 9 përfshin tre kategori kryesore të klasifikimit për pasuritë financiare: të matura me koston e amortizuar (KA), të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse (VDATGJ) dhe të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes (VDNFH). Ajo eliminon kategoritë ekzistuese të SNK 39 të letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim, huatë dhe llogaritë e arkëtueshme dhe letrat me vlerë në dispozicion për shitje.

Banka Kombëtare Tregtare Kosovë Sh.a.**Shënimet mbi pasqyrat financiare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018**

(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohet ndryshe)

3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)**(p) Standardet e reja të miratuara më 1 janar 2018 (vazhdim)****1) Klasifikimi i pasurive i financiare (vazhdim)**

Bazuar në modelet e përzgjedhura të biznesit, Banka ka vendosur të klasifikojë aktivet e saj financiare në kategoritë vijuese që nga 1 janari 2018:

Portofoli

i rishikuar më 31 dhjetor 2017	SNK 39 Matja dhe Klasifikimi		Testi VPPI	Modeli i Biznesit	SNRF 9 Klasifikimi dhe matja	Përfundimi
Thesari						
Para të gatshme dhe paradhënie të tjera për bankat	MPA	KA	Pritet të përmbushë kriteret e VPPI	Mbahen për të mbledhur flukse kontraktuale të parasë Mbahen për të mbledhur flukse kontraktuale të parasë	KA	Asnjë ndikim financiar nuk është identifikuar
Vendosja dhe balancimi me bankat	MPA	KA	Pritet të përmbushë kriteret e VPPI	Mbahen për të mbledhur flukse kontraktuale të parasë	KA	Asnjë ndikim financiar nuk është identifikuar
Në dispozicion për shitje - letrat me vlerë	GJPSH	VDATGJ	Pritet të përmbushë kriteret e VPPI	Mbahet për të mbledhur dhe shitur	VDATGJ	Asnjë ndikim financiar i identifikuar në këtë fazë. Por çdo instrument i ri që dështon testin SPPI në të ardhmen do të matet në FVPL me luhatshmëri pasuese të P & L për shkak të ndryshimit në FV.
Kredi për bankat	LAR	KA	Pritet të përmbushë kriteret e VPPI	Mbahen për të mbledhur flukse kontraktuale të parasë	KA	Duke pasur parasysh frekuencën dhe jo-materialitetin e tyre, shitjet mund të jenë në përputhje me një model biznesi, objektivi i të cilit është mbajtja e mjeteve financiare në mënyrë që të mbledhen flukset kontraktuale të parasë. Për më shumë, qëllimi I menaxhmentit të Bankës është t'i mbajë këto aktive deri në maturim.
Kreditë për klientët						
Kreditë për individ dhe korporatave	LAR	KA	Pritet të përmbushë kriteret e VPPI	Mbahen për të mbledhur flukse kontraktuale të parasë	KA	Asnjë ndikim financiar nuk është identifikuar.

3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

(p) Standardet e reja të miratuara më 1 janar 2018 (vazhdim)

2) Humbjet e pritshme nga provizionimet e kredive sipas 1 Janarit 2018

Ndikimi më i rëndësishëm në pasqyrat financiare të Bankës nga zbatimi i SNRF 9 rezulton nga kërkesat e reja të provizionimit. Humbjet nga provizionimet janë rritur dhe janë bërë më të paqëndrueshme për instrumentet financiare në kuadër të modelit të SNRF 9 të provizionimit.

Vlerësimi i rrezikut të kredisë të një portofoli të pasurive përfshin vlerësime të mëtejshme në lidhje me gjasat e mosveprimeve të ndodhura, të raporteve të humbjeve të lidhura ndërmjet palëve. Banka mat rrezikun e kredisë duke përdorur probabilitetin e dështimit (PD), ekspozimin ndaj dështimit (EAD) dhe humbja nga dështimi (LGD). Shih shënimin 5 (b), (ii).

Inputet kryesore në matjen e HPK-ve të vlerësuara dhe të rregulluara në bilancin fillestar të kapitalit të bankave më 1 janar 2018 janë të njëjta me ato të shënimit 5 (b), (ii), me përjashtim të LGD-së e cila u vlerësua si më poshtë:

Më 1 janar 2018, Banka bëri vlerësimet e bazuara fikse. Banka caktoi secilën lloj kolaterali në portofolin e BKT-së në segmentet LGD të Bazelit, secila me parametrat e tyre LGD për Portofolin e Korporatave dhe Individëve bazuar në të dhënat historike. Për segmentin e Sovranëve dhe Bankave, vlera e LGD-së është fikse 25% sipas kërkesave të Bazelit,

Gjatë vitit 2018, Banka rishikoi vlerësimin e LGD-së siç shpjegohet në shënimin 5 (b), (ii). Më 31 dhjetor 2018, Banka aplikoi ndryshimin në HPK, që rrjedh nga vlerësimi i LGD-së, në mënyrë prospektive.

Bazuar në vlerësimet e ndërmarra, totali i përlogaritur i adoptimit të SNRF 9 në bilancin fillestar të kapitalit të bankës më 1 janar 2018 ishte rreth 1,674,437 Euro.

Totali i provizioneve është 6,697,017 Euro, ose ekuivalent 2.21% e totalit të ekspozimit.

Banka ka vendosur që të mos rideklorojë periudhat krahasuese në zbatimin fillestar të SNRF 9.

Banka Kombëtare Tregtare Kosovë Sh.a.**Shënimet mbi pasqyrat financiare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018**

(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohet ndryshe)

3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)**(p) Standardet e reja të miratuara më 1 janar 2018 (vazhdim)****2) Humbjet e pritshme kreditor sipas 1 Janarit 2018 (vazhdim)****i. i pasqyrës së gjendjes së pozicionit financiar nga SNK 39 në SNRF 9 (vazhdim)**

Në Euro	Klasifikimi sipas SNK 39	Klasifikimi i ri sipas SNRF 9		Vlera e bartur sipas SNK 39	Rivlerësuara	Vlera e re e bartur sipas SNRF 9
Pasuritë Financiare			Pasuritë Financiare			
Paraja e gatshme dhe balancat në Bankën Qëndrore	Kreditë dhe të arkëtueshmet	Kostoja e amortizuar	Paraja e gatshme dhe balancat në Bankën Qëndrore	36,515,212	-	36,515,212
Plasmanet dhe balancat me Banka	Kreditë dhe të arkëtueshmet	Kostoja e amortizuar	Plasmanet dhe balancat me Banka	3,245,808	-	3,245,808
Bondet e thesarit	GJPSH	VDATGJ	Investimet në letra me vlerë – e matur me VDATGJ	15,981,321	-	15,981,321
Letra me vlerë të mbajtura për tregtim	VDNFH	VDNFH	Investimet në letra me vlerë – e matur me VDNFH	-	-	-
Letra me vlerë në dispozicion për shitje	GJPSH	VDATGJ	Investimet në letra me vlerë – e matur me VDATGJ	39,478,938	-	39,478,938
Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim	MPM	Kostoja e amortizuar	Investimet në letra me vlerë – e matur me kosto të amortizuar	-	-	-
Kreditë ndaj bankave	Kreditë dhe të arkëtueshmet	Kostoja e amortizuar	Kreditë ndaj bankave	30,537,890	35,830	30,502,060
Kredite ndaj klientëve	Kreditë dhe të arkëtueshmet	Kostoja e amortizuar	Kredite ndaj klientëve	212,081,878	1,564,297	210,517,581
Pasuritë tjera	Kreditë dhe të arkëtueshmet	Kostoja e amortizuar	Pasuritë tjera	5,356,508	74,310	5,282,198
Gjithsej pasuritë financiare				343,197,555	1,674,437	341,523,118
Detyrimet financiare						
Depozitat e klientëve	Kostoja e amortizuar	Kostoja e amortizuar	Depozitat e klientëve	301,678,067	-	301,678,067
Detyrimet ndaj bankave dhe institucioneve financiare	Kostoja e amortizuar	Kostoja e amortizuar	Detyrimet ndaj bankave dhe institucioneve financiare	20,009	-	20,009
Detyrimet ndaj palëve të treat	Kostoja e amortizuar	Kostoja e amortizuar	Detyrimet ndaj palëve të treat	5,906,343	-	5,906,343
Përlllogaritjet dhe detyrimet tjera	Kostoja e amortizuar	Kostoja e amortizuar	Accruals and other liabilities	2,552,934	-	2,552,934
Borxhi i varur	Kostoja e amortizuar	Kostoja e amortizuar	Borxhi i varur	-	-	-
Gjithsejt detyrimet tjera				310,157,353	-	310,157,353

Banka Kombëtare Tregtare Kosovë Sh.a.**Shënimet mbi pasqyrat financiare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018**

(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohet ndryshe)

3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)**(p) Standardet e reja të miratuara më 1 janar 2018 (vazhdim)****2) Humbjet e pritshme kreditore sipas 1 Janarit 2018 (vazhdim)****i. i pasqyrës së gjendjes së pozicionit financiar nga SNK 39 në SNRF 9 (vazhdim)**

Tabela në vijim analizon ndikimin, tatimin, të kalimit në SNRF 9 mbi rezervat dhe fitimet e pashpërndara. Ndikimi lidhet me rezervën e kredive të detyrimeve, rezervën e vlerës së drejtë dhe fitimet e pashpërndara. Nuk ka ndikim në komponentët e tjerë të kapitalit.

Ndikimi i pranimit
SNRF 9 më 1 Janar
2018

Në EURO

Rezerva e vlerës së drejtë (SNK 39 GJPSH)

Gjendja e mbyllur sipas SNK 39 (31 Dhjetor 2017) (39,205)

Riklasifikimi i investimeve në letra me vlerë(borxhi) nga të disponueshme për shitje në VDNFH -

Riklasifikimi i investimeve në letra me vlerë(kapitali) matur në kosto nga e disponueshme për shitje në VDATGJ -

Njohja e humbjeve të pritura kreditore nën SNRF 9 për pasuritë borxhi financiare (VDATGJ) -

Gjendja fillestare sipas SNRF 9 (1 Janar 2018) (39,205)

Fitimet e pashpërndara

Gjendja e mbyllur sipas SNK 39 (31 Dhjetor 2017) 17,756,475

Riklasifikimi nën SNRF 9 1,674,437

Njohja e humbjeve të pritura kreditore nën SNRF 9 (përfshirë qiratë e arkëtueshme, angazhimet kreditore dhe garancionet financiare -

Gjendja fillestare nën SNRF 9 (1 Janar 2018) 16,082,038

Tabela në vijim bashkërendon mbylljen e provizioneve për pasuritë financiare në përputhje me SNK 39 dhe provizionet për angazhimet e kredisë dhe garancitë financiare në përputhje me SNK 37, Detyrimet Kontingjente dhe Pasuritë më 31 Dhjetor 2017, me humbjet e pritura nga kreditë (HPK) të përcaktuar në përputhje me SNRF 9 më 1 janar 2018.

Lejimet në EURO	31 Dhjetor 2017 (SNK 39/SNK 37)	Riklasifikimi në VDNFH	Rivlerësimi	1 Janar 2018 (SNRF 9)
Pasuritë financiare				
Paraja dhe balancat në Bankën Qendrore	-	-	-	-
Plasmanet dhe balancat me Banka	-	-	-	-
Letrat me vlerë (HTM nën SNK 39)	-	-	-	-
Kreditë ndaj Bankave (L&R nën SNK 39)	-	-	35,830	35,830
Kreditë ndaj klientëve (L&R nën SNK 39)	5,022,580	-	1,564,297	6,586,877
Pasuritë tjera	-	-	74,310	74,310
Lejimet Totale për matjen e kostos së amortizuar	5,022,580	-	1,674,437	6,697,017
Letrat me vletë (GJPSH nën SNK 39)	-	-	-	-
Lejimet Totale me matje VDATGJ	-	-	-	-

Informacion i mëtejshëm mbi matjen e zbritjeve për provizionimet sipas SNRF 9 mund të gjendet në shënimin 3 (f) (ix) dhe 5 (b) (ii).

3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

(q) Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende efektive dhe nuk janë miratuar më herët nga Banka

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, BSNK publikon disa standarde të reja dhe ndryshime në standardet ekzistuese që nuk janë ende efektive dhe nuk janë miratuar herët nga Banka. Informacioni mbi ato që pritet të jetë relevante për pasqyrat financiare të Bankës është dhënë më poshtë. Menaxhimi parashikon që të gjitha deklaratimet përkatëse do të miratohen në politikat kontabël të Bankës për periudhën e parë që fillon pas datës efektive të shpalljes. Standarde të reja, amendamente dhe Interpretimet as të miratuara as të listuara më poshtë nuk janë shpalosur pasi ato nuk priten të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës

SNRF 16 ‘Qiratë’

SNRF 16 do të zëvendësojë SNK 17 dhe tre interpretime të lidhura. Ai përfundon projektin afatgjatë të BSNK-së për të rishikuar kontabilitetin e qirasë. Qiratë do të regjistrohen në pasqyrat financiare në formën e një pasurie me të drejtë të përdorimit dhe një detyrim qiraje. Ekzistojnë dy lehtësime të rëndësishme të parashikuara nga SNRF 16 për aktivet me vlerë të ulët dhe me qira afatshkurtër më pak se 12 muaj

SNRF 16 është në fuqi që nga 1 janari 2019. Adaptimi i mëhershëm është i lejuar; megjithatë banka ka vendosur të mos adaptojë më herët këtë standrad.

Menaxhmenti është në proces të vlerësimit të impaktit të plotë të këtij standardi. Deri më tani, banka ka:

- i. Ka vendosur të përdorë mjetet praktike për të mos kryer një rishikim të plotë të qirave ekzistuese dhe të zbatojë SNRF 16 vetëm për kontratat e reja ose të modifikuara. Meqë disa nga qiratë do të modifikohen ose rinovohen në vitin 2019, Banka i ka rivlerësuar këto qira dhe ka konkluduar se do të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar si një aktiv i së drejtës së përdorimit.
- ii. Beson se ndikimi më i rëndësishëm do të jetë që Banka do të duhet të njohë një pasuri të së drejtës së përdorimit dhe një detyrim qiraje për zyrën dhe ndërtesat që aktualisht trajtohen si qira operationale. Kjo do të thotë se natyra e shpenzimeve do të ndryshojë nga të qenit një shpenzim operativ i qirasë në zhvlerësim dhe shpenzime të interesit.
- iii. Merr në konsideratë kërkesat e sistemit të TI-së, si dhe nëse nevojitet një sistem i ri.
- iv. po vlerëson shpalosjet aktuale për qiratë financiare dhe qiratë operationale (Shënimi 33, Seksioni, 'angazhimet e qirasë') meqë ka të ngjarë të krijojnë bazën e shumave që duhet të kapitalizohen dhe të bëhen aktive me të drejtë përdorimi.
- v. Vlerëson dhënien e informacioneve shpjeguese shtesë që do të kërkohen.

Banka po planifikon të adaptojë SNRF 16 më 1 janar 2019 duke përdorur qasjen ‘metoda e modifikuar retrospektive e Standardit’. Sipas kësaj qasjeje, efekti kumulativ i zbatimit fillimisht të SNRF 16 njihet si një rregullim në kapital në datën e aplikimit fillestar. Informacioni krahasues nuk rideklarohet.

Zgjedhja e kësaj qasjeje të tranzicionit rezulton në vendime të mëtejshme të politikave që Banka duhet të bëjë pasi ka disa lehtësime të tjera kalimtare që mund të zbatohen. Këto lidhen me ato qera të mbajtura më parë si qera të zakonshme dhe mund të aplikohen në bazë të qirasë. Banka po vlerëson aktualisht ndikimin e zbatimit të këtyre lehtësirave kalimtare.

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Menaxhmenti diskuton me komitetin e auditimit zhvillimin, zgjedhjen dhe shpalosjen e politikave kritike kontabël dhe vlerësimeve të Bankës, si dhe aplikimin e këtyre politikave dhe vlerësimeve.

Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi menaxhimin e rrezikut financiar (referojuni shënimit 5). Në vijim janë gjykimet kritike, përveç atyre që përfshijnë vlerësimet (që trajtohen si të ndara më poshtë), që menaxhmenti ka bërë në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Bankës dhe që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare:

Vlerësimi i modelit të biznesit: Klasifikimi dhe matja e mjeteve financiare varet nga rezultatet e SPPI dhe testit të modelit të biznesit (shënimi 3, f), (iii)). Banka përcakton modelin e biznesit në një nivel që reflekton se si grupet e aseteve financiare menaxhohen së bashku për të arritur një objektiv të veçantë biznesi. Ky vlerësim përfshin gjykimin që pasqyron të gjitha provat relevante, duke përfshirë vlerësimin e performancës së aseteve dhe matjen e performancës së tyre, rreziqet që ndikojnë në performancën e aseteve dhe mënyrën se si menaxhohen ato dhe si kompensohen menaxherët e aseteve. Banka monitoron aktivet financiare të matura me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse që ç'regjistrohen përpara maturimit të tyre për të kuptuar arsyen për nxjerrjen e tyre dhe nëse arsyet janë në përputhje me objektivin e biznesit për të cilin është mbajtur pasuria. Monitorimi është pjesë e vlerësimit të vazhdueshëm të Bankës nëse modeli i biznesit për të cilin mbahet pasuria financiare e mbetur vazhdon të jetë e përshtatshme dhe nëse nuk është e përshtatshme nëse ka pasur një ndryshim në modelin e biznesit dhe kështu një ndryshim i ardhshëm në klasifikimin e tyre.

Rritja e ndjeshme e rrezikut të kredisë: Siç është shpjeguar në shënimin 3 (f) (ix) dhe 5 (b) (ii), HPK matet si një lejim i barabartë me HPK 12 muaj për pasuritë e fazës 1 ose pasuritë HPK të jetëgjatësisë për fazën 2 ose pasuritë e fazës së 3. Një pasuri kalon në fazën 2 kur rreziku i kredisë është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare. SNRF 9 nuk përcakton se çfarë përbën një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë. Në vlerësimin nëse rreziku i kredisë së një pasurie është rritur ndjeshëm, Banka merr në konsideratë informacionin cilësor dhe sasior të arsyeshëm dhe të mbështetur në mënyrë prospektive. Për më shumë detaje, referojuni shënimit 3 (f) (ix) dhe 5 (b) (ii).

Krijimi i grupeve të pasurive me karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë: Kur HPK-të maten në baza kolektive, instrumentet financiare grupohen në bazë të karakteristikave të rrezikut të përbashkëta. Referojuni shënimit 3 (f) (ix) dhe 5 (b) (ii), për detajet e karakteristikave të shqyrtuara në këtë aktgjykim. Banka monitoron përshtatshmërinë e karakteristikave të rrezikut të kredisë në mënyrë të vazhdueshme për të vlerësuar nëse ato vazhdojnë të jenë të ngjashme. Kjo është e nevojshme për të siguruar që karakteristikat e rrezikut të kredisë kur të ndryshojnë të kenë ri-segmentim të duhur të pasurive. Kjo mund të rezultojë në krijimin e portofoliove të reja ose në lëvizjen e aseteve në një portofol ekzistues që reflekton më mirë me karakteristikat e ngjashme të rrezikut të kredisë të atij grupi të pasurive. Ri-segmentimi i portofoliove dhe lëvizja midis portofoliove është më e zakonshme kur ka një rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë (ose kur kjo rritje e rëndësishme ndryshon) dhe kështu asetet lëvizin nga 12-mujore në HPK-të të përjetshme, ose anasjelltas, por mund të ndodhë edhe brenda portofoliove që vazhdojnë të maten në të njëjtën bazë të HPK-ve 12-mujore ose të përjetshme, por shuma e HPK ndryshon sepse rreziku i kredisë së portofoleve ndryshon.

Modelet dhe supozimet e përdorura: Banka përdor modele dhe supozime të ndryshme në matjen e vlerës së drejtë së pasurive financiare si dhe në vlerësimin e HPK. Gjykimi zbatohet në identifikimin e modelit më të përshtatshëm për secilin lloj të pasurisë, si dhe për përcaktimin e supozimeve të përdorura në këto modele, duke përfshirë supozimet që lidhen me drejtuesit kryesorë të rrezikut të kredisë. Shih shënimin 3 (f) (ix) dhe 5 (b) (ii) për më shumë detaje mbi HPK dhe shënimin 3 (f) (viii) për më shumë detaje mbi matjen e vlerës së drejtë.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë për pasuritë dhe detyrimet financiare për të cilat nuk ekziston një çmim tregu i vëzhgueshëm kërkon përdorimin e teknikave të vlerësimit siç përshkruhet në politikat kontabël 3 (e) (vi). Për instrumentet financiare të cilat tregtohen rrallë dhe që kanë transparencë të vogël të çmimeve, vlera e drejtë është më pak objektive, dhe kërkon nivele të ndryshme gjykimi në varësi të likuiditetit, përqendrimit, pasigurisë së faktorëve të tregut, supozimeve të çmimeve dhe rreziqeve të tjera që ndikojnë mbi instrumentin e caktuar. Shih gjithashtu "Vlerësimi i instrumenteve financiare" më poshtë.

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

Gjykimet kritike kontabël të bëra në zbatimin e politikave kontabël të Bankës përfshijnë:

Vlerësimi i instrumenteve financiare

Politika kontabël e Bankës për matjen e vlerës së drejtë është diskutuar në shënimin 3 (f) (viii).

Banka mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të metodave:

- **Niveli 1:** Çmimin e kuotuar të tregut-në një treg aktiv për një instrument të ngjashëm.
- **Niveli 2:** Teknikat e vlerësimit të bazuara në të dhëna të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin instrumentet e vlerësuar duke përdorur: çmimet e kuotuar në tregjet aktive për instrumente të ngjashme; çmimet e kuotuar për instrumente të ngjashme në tregje që konsiderohen më pak se aktivë; ose teknika tjera vlerësimi ku të gjithë të faktorët hyrës janë në mënyrë direkte ose indirekte të vëzhgueshëm nga të dhënat e tregut.
- **Niveli 3:** Teknikat e vlerësimit duke përdorur të dhëna të rëndësishme të pavëzhgueshme. Kjo kategori përfshin gjithë instrumentet ku metoda e vlerësimit përfshinë faktorë që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe të dhënat jo të vëzhgueshme mund të kenë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumente të cilat janë vlerësuar në bazë të çmimeve të kuotuar për instrumente të ngjashme ku rregullime të rëndësishme jo të vëzhgueshme ose supozime kërkohen për të reflektuar ndryshimin midis instrumenteve.

Vlera e drejtë e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare që tregtohen në tregje aktive bazohen në çmime tregu të kuotuar ose kuotime çmimesh tregtarësh. Për të gjitha instrumentet financiare tjera Banka përcakton vlerën e drejtë duke përdorur teknikat e vlerësimit. Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modelet e skontuara të parave, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat ekzistojnë çmime tregu të mbikëqyrur, modelin “polynomial” të çmimeve të opsioneve dhe metoda tjera të vlerësimit.

Banka për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumenteve më të zakonshme dhe më të thjeshta përdor modele të vlerësimit të njohura gjerësisht siç janë swap-et e normave e interesit dhe monedhave që përdorin vetëm të dhëna të publikuara tregu dhe që kërkojnë pak gjykim dhe vlerësim nga menaxhmenti. Çmimet e vëzhgueshme dhe modelet e të dhënave janë zakonisht në dispozicion në tregjet e listuara për borxhet dhe letrat me vlerë të kapitalit, instrumentet derivative të tregtueshme dhe instrumentet që tregtohen në tregjet e letrave me vlerë të tilla si normat e interesit sëap. Disponueshmëria e çmimeve të publikuara në tregje dhe e modelit të të dhënave redukton nevojën e menaxhmentit për gjykim dhe vlerësim, dhe gjithashtu redukton pasigurinë e shoqëruar në përcaktimin e vlerës së drejtë. Disponueshmëria e çmimeve në treg dhe modeleve të të dhënave ndryshon në varësi të produkteve dhe tregjeve dhe është i prirur që të ndryshojë në bazë të ngjarjeve të veçanta dhe kushteve të përgjithshme të tregjeve financiare.

Për instrumente më të ndërlikuara, Banka përdor modele vetanake të vlerësimit, të cilat zakonisht janë të zhvilluara nga modele të njohura të vlerësimit. Disa ose të gjitha të dhënat e rëndësishme në këto modele mund të mos jenë të vëzhgueshme në treg, dhe janë nxjerrë nga çmimet ose normat e tregut, ose janë vlerësuar bazuar në supozime. Modelet e vlerësimit që përdorin të dhëna të rëndësishme të pavëzhgueshme kërkojnë një shkallë më të lartë gjykimi dhe vlerësimi në përcaktimin e vlerës së drejtë. Gjykimi dhe vlerësimi i menaxhmentit zakonisht janë të nevojshme për zgjedhjen e modelit të vlerësimit që do të përdoret, përcaktimin e flukseve monetare të pritshme të instrumentit financiar që vlerësohet, përcaktimin e probabilitetit të dështimit në pagesë nga pala e kundërt dhe përzgjedhjen e normave të përshtatshme skontuese.

Banka Kombëtare Tregtare Kosovë Sh.a.**Shënimet mbi pasqyrat financiare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018**

(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohet ndryshe)

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)**Vlera e drejtë (vazhdim)**

Tabela e mëposhtme paraqet vlerat kontabël dhe vlerat e drejta të pasurive dhe detyrimeve financiare si dhe analizon instrumentet financiare të matura në vlerën e drejtë në fund të periudhës raportuese, nga niveli në hierarkinë e vlerës së drejtë në të cilën matja e vlerës së drejtë kategorizohet:

31 Dhjetor 2018	Shënim	Shuma bartëse	Vlera e drejtë			Total
			Level 1	Level 2	Level 3	
Llogaritë dhe balancat me bankat	7	18,271,569	-	18,271,569	-	18,271,569
Investimet në letra me vlerë	8	76,807,878	55,738,302	21,069,577	-	76,807,878
Të arkëtueshmet nga BKT Shqipëria	25	10,641,096	-	10,641,096	-	10,641,096
Kreditë ndaj klientëve	9	247,370,257	-	247,370,257	-	247,370,257
Gjithsej pasuritë financiare		353,090,800	55,738,302	297,352,499	-	353,090,800
Depozitat e klientëve	13	351,354,331	-	351,354,331	-	351,354,331
Detyrimet ndaj bankave	14	17,859,118	-	17,859,118	-	17,859,118
Huazimet	16	4,085,314	-	4,085,314	-	4,085,314
Gjithsej detyrimet financiare		373,298,763	-	373,298,763	-	373,298,763
31 Dhjetor 2017	Shënim	Shuma bartëse	Level 1	Level 2	Level 3	Total
Llogaritë dhe balancat me bankat	7	1,374,043	-	1,374,043	-	1,374,043
Investimet në letra me vlerë	8	55,460,258	39,478,938	15,981,321	-	55,460,258
Kreditë ndaj bankave	9.1	1,871,765	-	1,871,765	-	1,871,765
Kreditë ndaj klientëve	9.2	212,081,878	-	212,081,878	-	212,081,878
Gjithsej pasuritë financiare		270,787,944	39,478,938	231,309,007	-	270,787,944
Depozitat e klientëve	13	301,678,067	-	301,678,067	-	301,678,067
Detyrimet ndaj bankave	14	20,009	-	20,009	-	20,009
Huazimet	16	5,906,343	-	5,906,343	-	5,906,343
Gjithsej detyrimet financiare		307,604,419	-	307,604,419	-	307,604,419

5. Menaxhimi i rrezikut financiar

(a) Të përgjithshme

Banka i ekspozohet rreziqeve të mëposhtme nga instrumentet financiare:

- Rreziku kreditor
- Rreziku i likuiditetit
- Rreziqet e tregut
- Rreziku operacional

Ky shënim paraqet informacione rreth ekspozimit të Bankës ndaj secilit nga rreziqet më lartë, qëllimet e Bankës, politikat dhe proceset për matjen dhe menaxhimin e rrezikut, dhe menaxhimin e kapitalit të Bankës.

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon të drejtën për të marrë mjete monetare ose ndonjë pasuri tjetër financiare nga një palë tjetër (pasuri financiare) ose detyrimin për të dhënë mjete monetare ose pasuri tjetër financiare tek një palë tjetër (detyrim financiar). Instrumentet financiare sjellin rreziqe të caktuara për Bankën. Rreziqet më të rëndësishme me të cilat përballet Banka janë rreziku kreditor, rreziku i likuiditetit dhe rreziku i tregut. Rreziku i tregut përfshin rrezikun e valutave të huaja, rrezikun e normës së interesit dhe rrezikun e çmimeve të tjera.

Struktura e menaxhimit të rrezikut

Bordi drejtues i BKT-së ka përgjegjësi për themelimin dhe mbikqyrjen e strukturës së menaxhimit të rrezikut. Bordi ka themeluar komitetin e bankës për pasuri dhe detyrime (KPD) në Zyrën Qendrore, Grupin e menaxhimit të riskut dhe komitetet e kreditimit, të cilat janë përgjegjëse për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të menaxhimit të rrezikut në fushat e tyre të caktuara. Të gjitha këto organe i raportojnë rregullisht bordit të drejtorëve për aktivitetet e tyre.

Politikat e menaxhimit të riskut të Bankës janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet që has Banka, për të vendosur kufizime të rrezikut dhe kontrole të përshtatshme, dhe për të monitoruar zbatimin e këtyre kontrolleve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Banka, nëpërmjet trajnimeve dhe standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar, në të cilin çdo punonjës do të kuptojë rolin dhe detyrimet përkatëse.

Komiteti i auditimit në Zyrën Qendrore është përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë me politikat dhe procedurat e menaxhimit të rrezikut të Bankës, dhe për të vlerësuar mjaftueshmërinë e strukturës së menaxhimit të rrezikut në lidhje me rreziqet e hasura nga Banka. Komiteti i auditimit ndihmohet në kryerjen e detyrave nga auditimi i brendshëm. Auditimi i brendshëm ndërmerr kontrole të rregullta dhe të rastit për procedurat dhe kontrollat e menaxhimit, rezultatet e të cilave raportohen tek komiteti i auditimit.

(b) Rreziku kreditor

Rreziku kreditor është rreziku i humbjes financiare të Bankës nëse klienti apo pala tjetër në një instrument financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale, dhe rrjedh kryesisht nga kreditë e Bankës për klientët, për bankat e tjera dhe nga letrat me vlerë. Për qëllime të raportimit të menaxhimit të rrezikut, Banka konsideron të gjitha elementët e ekspozimit ndaj rrezikut kreditor (si rrezikun individual të klientit për mospagesë, rrezikun e vendit dhe të sektorit). BKT – Kosova ka formuar një komitet kreditor për të mbikëqyrur miratimin e kërkesave për kreditë deri në shumën 500,000 Euro. Kërkesat kreditore në shuma mbi 500,000 Euro miratohen vetëm me vendimin e bordit të drejtorëve. Ka një përqendrim të vazhdueshëm për mbikqyrjen e cilësisë së kredive të dhëna si në kohën e miratimit dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së tyre.

Çdo njësi biznesi i kërkohet të jetë në përputhje me politikat dhe procedurat e kreditimit të Bankës. Auditime të rregullta të njësive të biznesit dhe proceseve të menaxhimit të rrezikut janë ndërmarrë nga auditimi i brendshëm.

Banka Kombëtare Tregtare Kosovë Sh.a.

Shënimet mbi pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018

(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohet ndryshe)

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

i. Ekspozimi maksimal kreditor

Vlera kontabël bruto e pasurive financiare më poshtë paraqet gjithashtu ekspozimin maksimal të Bankës ndaj rrezikut të kredisë për këto pasuri. Ekspozimet maksimale ndaj rrezikut të kredisë para kolateralit dhe përmirësime të tjera të kredisë më 31 Dhjetor 2018 dhe 31 Dhjetor 2017 janë si më poshtë:

Rreziku kreditor për instrumentet financiare

	31 Dhjetor 2018			31 Dhjetor 2017		
	Ekspozimi para provizionimeve	Provizionimet	Ekspozimi neto per rrezik kreditor	Ekspozimi para provizionimeve	Provizionimet	Ekspozimi neto per rrezik kreditor
A. Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor i lidhur me zërat e bilancit						
Paraja dhe balancat e parasë me Bankën Qendrore	53,319,751	-	53,319,751	36,515,212	-	36,515,212
Plasmanet dhe balancat me bankat	28,919,138	(6,473)	28,912,665	3,245,808	-	3,245,808
Bonot e thesarit	-	-	-	15,981,321	-	15,981,321
Letrat me vlerë të mbajtura për tregtim	-	-	-	-	-	-
Letrat me vlerë në dispozicion për shitje	-	-	-	39,478,938	-	39,478,938
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	-	-	-	-	-	-
Investimet në letrat me vlerë të matura sipas VDNFH	-	-	-	-	-	-
Investimet në letra me vlerë të matura sipas VDATGJ	68,592,401	(138,991)	68,453,409	-	-	-
Investimet në letra me vlerë sipas kostos së amortizimit	8,375,297	(20,828)	8,354,469	-	-	-
Kreditë dhënë bankave	-	-	-	30,537,890	(35,830)	30,502,060
Kreditë ndaj konsumatorëve	250,018,045	(2,647,789)	247,370,257	212,081,878	(1,564,297)	210,517,581
Prona dhe pajisjet	1,769,094	-	1,769,094	1,972,635	-	1,972,635
Asetet e pa prekshme	22,414	-	22,414	35,556	-	35,556
Asetet tjera	4,738,267	(633,070)	4,105,197	5,356,508	(74,310)	5,282,198
Gjithsej Asetet	415,754,407	(3,447,151)	412,307,256	345,205,747	(1,674,437)	343,531,310
Zërat jashtëbilancor						
Angazhimet e pakthyera të kredisë	67,173,252	-	67,173,252	110,429,590	-	48,000,574
Çeqet e papaguara të bankave jorezidente	-	-	-	493,368	-	-
Kontrata në valutë të huaj	2,662,150	-	2,662,150	148,408,727	-	-
Kolaterali për portfolion e kredive	700,488,617	-	700,488,617	2,821,969,922	-	634,191,900
Letrat me vlerë të vendosura si kolateral	3,500,000	-	3,500,000	340,865,572	-	-
Gjithsej zërat jashtëbilancor	773,824,019	-	773,824,019	3,422,167,179	-	682,192,475
Gjithsej ekspozimi ndaj rrezikut kreditor	1,189,578,427	(3,447,151)	1,186,131,276	7,049,893,735	(1,674,437)	1,025,723,785

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

ii. Matja e pritshme e humbjeve kreditore (HPK)

Vlerësimi i ekspozimit të kredisë për qëllime të administrimit të rrezikut është kompleks dhe kërkon përdorimin e modeleve, pasi ekspozimi ndryshon me ndryshimet në kushtet e tregut, rrjedhat e pritshme të parasë dhe kalimin e kohës. Vlerësimi i rrezikut të kredisë të një portofoli të pasurive përfshin vlersime të mëtejshme në lidhje me gjasat e dështimeve të ndodhura, të humbjeve të lidhura dhe korrelacionin e dështimit ndërmjet palëve. Banka mat rrezikun e kredisë duke përdorur probabilitetin e dështimit (PD), ekspozimin në dështim (EAD) dhe humbjen e dhënë të dështuar (LGD).

Parimi udhëzues i modelit të pritshëm të humbjes kreditore është të pasqyrojë modelin e përgjithshëm të përkeqësimit ose përmirësimit të cilësisë kreditore të instrumenteve financiare. Kjo cilësi kreditore varet nga shkalla e përkeqësimit kreditorë që nga njohja fillestare dhe do të përhapet në tri faza:

"Faza 1" përfshin ato asete që nuk kanë pësuar ndonjë përkeqësim të ndjeshëm të cilësisë kreditore që nga njohja fillestare;

"Faza 2" përbëhet nga asetet që kanë pësuar një përkeqësim të konsiderueshëm që nga njohja fillestare;

"Faza 3" ka të bëjë me të gjitha asetet ku ka ndodhur një dështim.

Sipas kësaj qasjeje të përgjithshme, HPK për një pasuri llogaritet në kohë të ndryshme sipas fazës që i është caktuar:

HPK mbi një vit për pasuritë në fazën 1;

HPK gjatë pjesës së mbetur për asetet në fazën 2 dhe fazën 3.

Caktimi i fazës bëhet sipas rregullave të mëposhtme:

Provizionimi: nëse pala tjetër për pasurinë e konsideruar ka dështuar, pasuria është caktuar në "Fazën 3". Një pasuri konsiderohet si i dështuar nëse ndonjë pagesë (principal ose interes) është vonuar për më shumë se 90 ditë ose nëse pala tjetër është në një gjendje të vërtetuar të falimentimit (falimentimit).

Vlerësimi D (më i ulët se C): Pasuritë me këtë vlerësim aktualisht konsiderohen të jenë në fazën 3.

Faktorët cilësorë: SNRF 9 ka këshilluar që të marrë parasysh faktorët cilësorë siç janë listat e shikimit ose analizat financiare nga ekspertët. Ngjashëm me rastin e mëparshëm, ekziston edhe një prag i dytë. Në rast se pagesa ë një kësti është e vonuar për më shumë se 30 ditë dhe më pak se 90 ditë, ajo caktohet në "Fazën 2".

Pragu Relativ: nëse pala tjetër ka pësuar një përkeqësim të ndjeshëm të rrezikut kreditorë, domethënë nëse cilësia e saj e kredisë që nga njohja fillestare ka rënë më shumë se një prag relativ i paracaktuar, atëherë ai i caktohet "Fazës 2".

Të gjitha asetet që nuk janë në rastet e mëparshme janë të caktuar në "Fazën 1".

Grupimi i instrumenteve për humbjet e matura në baza kolektive

Për provizionet e humbjeve të pritshme kreditore të modeluara në baza kolektive, bëhet një grupim ekspozimesh në bazë të karakteristikave të përbashkëta të rrezikut, të tilla që ekspozimet e rrezikut brenda një grupi janë homogjene.

Gjatë kryerjes së këtij grupimi, duhet të ketë informata të mjaftueshme për grupin të jetë statistikisht i besueshëm.

Kur informata të mjaftueshme nuk janë të disponueshme brenda vendit, Banka ka konsideruar krahasimin e standardeve, të dhëna shtesë të brendshme / të jashtme për t'u përdorur për qëllime të modelimit

Banka ka tre portofolio kryesore, të cilat janë:

- Portofolio e kredisë
Kjo kategori përfshin kreditë e shitjes me shumicë dhe individuale / me pakicë.
- Portofolio e thesarit
Kjo kategori përfshin bondet, bonot e thesarit dhe llogaritë e kapitalit.
- Financimi i projekteve dhe financimi i strukturuar
Kjo kategori përfshin letra kredie dhe garanci bankare.

